

Ac.nr.4860/15

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Isa Kelmendi, kryetar i kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Albert Zogaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a në Prishtinë, të cilin e përfaqëson R.Xh., kundër të paditurit I.G., nga Prishtina, Lagja “...” SU-4-4F6, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 948,19 €, duke vendosur përkitazi me ankesën e të paditurit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1287/13 të datës 03.09.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1287/13 të datës 03.09.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh. a me seli në Prishtinë dhe detyrohet i padituri I.G. nga Prishtina, që paditëses në emër të borxhit për impulset telefonike të shpenzuara nga telefoni fikës nr. 038-46-930, për periudhën kontestuese dhe atë për muajt 1,7,8,9,10,11 dhe 12 të vitit 2001, ti paguaj shumën prej 948.19 €, me kamatë siç e paguajnë bankat vendore për deponimet me kursim pa destinim të caktuar me kohëzgjatje më shumë se një vit nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shumën prej 30 €, në emër të shpenzimeve procedurale në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka parashtruar ankesë i padituri, për shkak të, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet apo i njëjti të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 të LPK-së gjeti se :

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në bazë të propozimit për përmbartim të paditëses (kreditorit) të cilit i janë bashkangjitur faturat për impulset e shpenzuara për telefonin nr. 038-46-930, e në shfrytëzim të paditurit (debitorit) gjykata e shkallës së parë me aktvendim E nr. 1469/02 të dt. 19.11.2002, e ka caktuar ekzekutimin duke detyruar të paditurin të paguan në emër të borxhit për

impulset e shpenzuara shumën prej 948,19 €, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës përmbare. Mirëpo, në bazë të kundërshtimit çështja ka kaluar në procedurën kontestimore dhe pas përfundimit të shqyrtimit kryesor gjykata e shkallës së parë ka vendosur më afërsisht e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Aktgjykimi i atakuar nuk është i përshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të përcaktuara me nenin 182 .2 të LPK, të cilat i vështron gjykata e shkallës së dytë në bazë të detyrës zyrtare komfor nenit 194 të LPK. Për shkak të aplikimit të rregullt të procedurës kontestimore në këtë çështje juridike drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale në të cilën kujdeset gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet ankimore e të paditurit sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike janë të pabazuara sepse nga faturat e paditëses vërtetohet se i padituri i ka mbetur borxh paditëses shumën prej 948.19 €. Po ashtu është i pabazuar dhe irelevant pretendimi ankimor sa i përket ligjit për faljen e borxhit publike nr. 05/L-043, për arsye se ky ligj nuk ka ndikim për vendosje në këtë çështje juridike dhe po qese i padituri mendon se i përmbush kushtet nga neni 4 të këtij ligji për faljen e borxheve duhet të drejtohet me kërkesë paditëses jashtë procedurës gjyqësore për faljen e borxhit por kundërshtimi i tij përkatësisht pretendimi se ky ligj duhet të zbatohet edhe nga gjykata është i pabazuar dhe irelevant për vendosjen e kësaj çështje juridiko kontestimore.

Meqë aktgjykimi i atakuar nuk është përfshi me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 200 të LPK, e refuzoj ankesën e të paditurit , kurse aktgjykimin e atakuar e vërtetoj.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.4860/15 të datës 20.03.2017

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Isa Kelmendi.d.v.